



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC

Më
Data

21-12-2017

P.nr. 1893/17

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni penal si gjykatë e shkallës së parë me gjyqtarë Hysnije Gashi si dhe me bashkëpunëtoren profesionale Albina Varoshi, në çështjen penale kundër te akuzuarit [REDACTED], për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1te KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.310-2/16 të dt. 27.07.2017, duke vendosur lidhur me kërkesën e PTH në Ferizaj, për dhënien e urdhrit ndëshkimor dënim me gjobë, gjykata me dt.12.10.2017 mori këtë:

AKT GJYKIM

PRANOHET kërkesa e PTHF në Ferizaj Ferizaj PP/II.nr.310-2/16 të dt. 27.07.2017 dhe kjo gjykatë shqipton këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri [REDACTED] i lindur me datë [REDACTED], nga i ati [REDACTED], e me vendbanim në fshatin [REDACTED], Komuna [REDACTED] (me nr. Personal [REDACTED]), ka të kryer shkollën e mesme, student, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Me datë 29.02.2016 rreth orës 17:29, në rrugën magjistrale Gjilan – Ferizaj në fshatin Dardani, Komuna Ferizaj duke drejtuar automjetin e markës 'VW 1 J', me targa të regjistruar [REDACTED], duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 55/1 të LSKRR-së, nga pakujdesia, duke mos e mbajtur distancën e sigurisë ndërmjet automjetit përpara, me pjesën e përparme e godet në pjesën e pasme automjetin e markës 'audi A3', me targa [REDACTED], të cilin e drejtonte [REDACTED], me të cilin rast pos dëmeve materiale lëndime të lehta trupore pësojnë [REDACTED] dhe [REDACTED], lëndime këto të përshkruara në ekspertizën mjeko- ligjore të datës 26.03.2017

Me te cilën kreu veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 e KPK-së.

Andaj , Gjykata në bazë të nenit 4,41,46, dhe 73, të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së,

GJYKON

Të pandehurin me dënim me gjobë në shumë prej 200 €, (dyqind euro) të cilin dënim është i obliguar ta paguaj ne në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

- Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.
- Të dëmtuarit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR], Komuna e [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.
- Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor te paguajnë shumën prej 20€ si dhe shpenzimet për ekspertize te komunikacionit ne vlerë prej 90.88 € në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.310-2/16 të dt. 27.07. 2017 ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR] për vepër penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e

urdhrit ndëshkimor PP/II.nr.310-2/16 të dt. 27.07. 2017 me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.të KPPK-së.

Gjykata duke i shikuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës që në fazën e administrimit të provave si leximi dhe konstatimi i ekspertit te komunikacionit i datës 15.02.2017, ekspertit te mjekësisë ligjore i datës 26.03.2017, deklarata e të pandehurit e dt.29.02.2016, deklarata e të dëmtuarit e dt.29.02.2016 si dhe fotografitë te cilat gjenden ne shkresat e lendes vendosi si ne dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Konform nenit 450 par.2.6 të KPPK-së obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor te paguajë shumën prej 20€ si dhe shpenzimet për ekspertize te komunikacionit ne vlerë prej 90.88 € në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ


P.nr.893/17 dt.12.10.2017

Bashkëpunëtore profesionale,

Albina Varoshi

Gjyqtarja,

Hysnije Gashi



UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimin të aktgjykimit të njëjtës gjykatë.